



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 14.07.2020  
Dokument parlamentar

**RAPORT**  
**MBI SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**  
**NR.11536, DATË 08.07.2020, “PËR KTHIMIN NË KUVEND TË**  
**LIGJIT NR.74/2020, “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË**  
**PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHITETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE**  
**SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË**  
**MINISTRINË E BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

- *Hyrje*

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 14.07.2020, Dekretin e Presidentit të Republikës nr.11536, datë 08.07.2020 “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.74/2020 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar”.

Për shqyrtimin i pretendimeve të ngritura në Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit për rishqyrtim, të pranishëm në komision ishin z.Sandër Lleshaj, Ministër i Brendshme dhe z.Julian Hodaj, Zvendësministër i Brendshëm.

Gjithashtu për të mbrojtur argumentat e kthimit të ligjit për rishqyrtim, nga komisioni u ftuan të merrnin pjesë edhe përfaqësues të Presidentit të Republikës të cilët nuk iu përgjigjën ftësës për të marrë pjesë në komisioni.

Po ashtu u ftuan edhe përfaqësues të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të cilët nuk ishin të pranishëm në mbledhje por kundërgargumentat e tyre për Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit objekt diskutimi na i dërguan me email.

- *Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr.74/2020 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar”.*

*Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.74/2020 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar, duke argumentuar si më poshtë::*

1. *Problematika në titullin e Ligjit nr. 74/2020, si dhe në teknikën legislative të përdorur në shkrimin e tij.*

Titulli i ligjit nr. 74/2020 nuk reflekton ndryshimin që bëhet përmes tij në ligjin bazë nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

Titulli i ligjit nr. 74/2020 është po njësoj si titulli i ligjit nr. 12/2018, pra “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar, ndërkohë që ligji nr. 74/2020 nuk është një ligj i ri, siç lë të kuptohet titulli i tij.

Ligji nr. 74/2020, objekt shqyrtimi, është një ligj që bën vetëm një shtesë dhe një ndryshim. Është e tepërt të shpjegojmë se titulli i ligjeve ndryshuese duhet të tregojë faktin e ndryshimeve, duke përdorur fjalët të përshtatshme si fjalët “ndryshime”, ose “ndryshime dhe shtesa”.

2. *Këto pasaktësi në anën formale të hartimit të ligjit, që rrezikojnë të sjellin dhe pasiguri në zbatim, vërehen dhe në shtimin në mënyrë të gabuar nga pikëpamja e teknikës legislative, të pikës 3, të nenin 6, të ligjit bazë, përmes nenit 1 të ligjit nr. 74/2020.*

Në nenin 6 të ligjit ekzistues, pika 3 është shfuqizuar me ndryshimet që janë bërë me ligjin nr. 20/2019. Mjafton referimi në dokumentin që ka orientuar për vite me radhë procesin e hartimit të ligjeve, përgatitur nën asistencën e eksperteve të misionit “EURALIUS”, që kanë orientuar qartë edhe mbi teknikën legislative, për të propozuar në mënyrë korrekte ndërhyrjet në një ligj ekzistues.

Konkretisht, kur ndryshohet një ligj që është ndryshuar më parë, hartuesi duhet të përfshijë dispozitat e reja në tekstin origjinal të ligjit ashtu siç ai rezulton nga ndryshimet e mëparshme dhe jo në tekstin e ligjit, ose ligjeve që kanë ndryshuar tekstin origjinal të ligjit. [...]. Si rrjedhojë, numrat dhe shkronjat e një neni të shfuqizuar nuk duhet të përdoren tek nenet ndryshuese, përveçse kur i gjithë neni është ndryshuar.

Ndaj dhe shtesa duhet të ishte paraqitur si një pikë e re, në fund të nenit apo me fraksion të pikës pararendëse, sipas zgjedhjes së ligjvënësit.

Këto elemente janë tepër të rëndësishme, pasi jo vetëm që lidhen pandashmërisht me cilësinë e ligjeve, por shmangin konfuzionin që krijohet gjatë zbatimit të tij. Duke qenë se ligji bazë, apo dhe ndryshimet e tij më pas, kanë gjetur zbatim dhe krijuar pasoja për një periudhë të caktuar, zbatuesi i ligjit duhet të jetë në gjendje në të ardhmen të identifikojë si ka qenë legjislacioni i zbatueshëm.

Kjo nevojë për identifikimin e legjislacionit të zbatueshëm në periudha të caktuara kohore dhe përmbajtjes konkrete të tij, lidhet direkt me sigurinë juridike. Siguria juridike, si koncept kushtetues i trajtuar disa herë nga praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ.

*3. Sipas nenit 1 të ligjit nr. 74/2020, parashikohet një shtesë në nenin 6 të ligjit bazë nr. 12/2018, ku konkretisht pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:*

“3. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ushtron veprimtarinë paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.”.

3.1 Lidhur me përmbajtjen e shtesës së bërë në nenin 6, të ligjit nr. 12/2018, sipas relacionit shoqërues të nismën kjo shtesë justifikohet me nevojën se:

*“Si ligji ekzistues ashtu dhe ndryshimi i tij, i cili rregulloi mirëfunksionimin e procesit të vlerësimit në vazhdimësi, ka një vakum ligjor, duke mosparashikuar shprehimisht në ligj, afatin apo kohën kur i lind e drejta SHÇBA-së për fillimin e procesit të vlerësimit për subjektet e përcaktuara në ligj. Në frymën e ligjit, ligjvënësi ka nënkuptuar që kjo e drejtë i lind pas mbarimit të veprimtarisë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për subjektet e tij.”*

Në fakt, asnjë dispozitë e ligjit bazë nga ana formale, nuk duket të ketë penguar që ky proces të vijonte paralelisht. Pasi nëse një fakt i tillë do të ekzistonte vërtet, kjo do të ishte evidentuar që në momentin e parë kur qeveria dhe Kuvendi, vlerësoi të ndërhynte në ligjin bazë në vitin 2019, moment ky kur Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat iu dha kompetenca për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar.

Për më tepër që, në nenin 5 të ligjit nr. 12/2018, kur citohen organet e vlerësimit kalimtar, është e qartë se veprimtaria e tyre kryhej në mënyrë të pavarur nga njëra- tjetra, pikërisht prej ndarjes së subjekteve që vlerëson secili prej tyre.

E njëjta logjikë ndiqet dhe nga nenet 34 e vijues të ligjit nr. 12/2018, kur detajohet procedura e vlerësimit hap pas hapi dhe referohen organet e vlerësimit me lidhëzën “ose”.

Në këto kushte, ky saktësim që propozohet sot është në fakt një justifikim i mosvijimit të procesit deri më tani dhe shtesë e përdorur për të justifikuar gjithashtu ndryshimin që i bëhet afatit në nenin 2, të ligjit nr. 74/2020.

Pengesa që krijohet për mosvijimin e procesit paralelisht lidhet me varësinë që ka ecuria e procesit të vlerësimit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, që duhet të kryejë më parë vlerësimin e punonjësve në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

3.2 Nga ana tjetër, nisur nga fakti që ky ndryshim që vjen brenda një viti, bën të nevojshëm që të ripërsërisim qëndrimin e mbajtur me Dekretin nr. 11175, datë 19.4.2019 të Presidentit të Republikës, me anë të së cilit është kthyer për rishqyrtim në Kuvend, ligji nr. 20/2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018, ‘Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””.

Njësoj si ligji nr. 20/2019, edhe ky ligj cenon parimet dhe standardet e vendosura në ligjin bazë nr.12/2018. Viojnë të mungojnë garancitë e nevojshme se një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës, do të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri, duke bërë hapa pas në raport me standardet e ligjit në fuqi.

Ndërsa kompetencat e realizimit të procesit të vlerësimit kalimtar të forcave policore dhe atyre të Gardës së Republikës, u janë hequr komisioneve të pavarura teknike dhe do të ushtrohen nga ana e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, një organ ky në varësi të drejtpërdrejtë të autoritetit politik të Ministrit të Brendshëm, sjellim në vëmendjen tuaj atë që ju vetë keni cituar në relacionin shoqërues të nismës, sipas së cilit janë kryer vetëm 15 vlerësime subjektsh nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Po në realcion, citohet se: “SHÇBA-ja, nëpërmjet trupave të vlerësimit të vlerësuara me parë sipas një procedure me përparësi nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, të kenë të drejtën e shprehur në ligj, të ushtrojnë veprimtarinë paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit”.

Ky fakt krijon dyshime të theksuara për selektivitet dhe subjektivizëm në kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar nga ana e SHÇBA-së, pasi ky moment është i lidhur me faktin se sot dihet tashmë se cilët janë personat brenda kësaj strukture (SHÇBA) që kanë kaluar procesin e vlerësimit.

Pra përmes ndryshimeve të vitit 2019 dhe ndryshimeve që tentohen të realizohen me ligjin nr. 74/2020, jo vetëm që vlerësimi i një pjese i kalon për realizim jo të gjithë trupës së strukturës së SHÇBA-së, por vetëm një pjesë të vogël të saj që mund të ketë kaluar aktualisht procesin e vlerësimit. Kjo rrit edhe më shumë kontrollin politik të Ministrit të Brendshëm mbi këtë proces.

Jo vetëm që mungon transparenca mbi mënyrën se si janë përzgjedhur subjektet që kanë kaluar procesin e vlerësimit me përparësi, por rritet dhe mundësia që ky proces të ushtrohet nën ndikim politik, duke mos garantuar standardin e domosdoshëm për realizimin e këtij procesi me objektivitet, pavarësi dhe paanshmëri.

4. Me ndryshimin e propozuar përmes nenit 2, të ligjit nr. 74/2020, në nenin 13 të ligjit bazë, afati “brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit”, shfuqizohet. Kështu, veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që duhet të mbaronte në qershor 2020, hiqet dhe veprimtaria e këtij komisioni lihet pa asnjë afat përfundimi.

4.1 Një ndryshim i tillë është i papranueshëm për arsyet që do të shpjegohen më poshtë. Edhe pse nisur nga ecuria aktuale, ka qenë i pamundur respektimi i afatit, ai mund të duhet të shtyhet, duke përcaktuar një afat objektiv, por kurrsesi të hiqet.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, me ndryshimet e bëra përmes ligjit nr. 20/2019, është shfuqizuar neni 68 i ligjit nr. 12/2018, që parashikonte se: “Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat do të përfundojë brenda një periudhe prej 24 muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

Ky ndryshim është vlerësuar i papranueshëm nga Presidenti i Republikës, i cili me Dekretin nr. 11175, datë 19.4.2019, këto ndryshime ligjore i ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend, duke argumentuar pikërisht këtë çështje.

Ndërsa tani, përmes ligjit nr. 74/2020, synohet të shfuqizohet edhe afati brenda të cilit duhet të përmbylle veprimtarinë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, që objekt të punës së tij ka këto kategori funksionarësh:

- a) drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor e zëvendësdrejtor vendor dhe shef komisariati, në Policinë e Shtetit;
- b) komandant, zëvendëskomandant dhe kolonel në Gardën e Republikës;
- c) punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Ky shfuqizim i afatit, pa përcaktuar një afat të ri brenda të cilit duhet të përmbyllet vlerësimi kalimtar për kategorinë e drejtuesve të lartë në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe të punonjësve në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, përveçse nuk është në përputhje me qëllimin e vetë ligjit që u miratua si nevojë e një reforme prioritare në Policinë e Shtetit, ngjan më shumë me një “favor” që u bëhet këtyre drejtuesve aktualë, për të mos kaluar në procesin e vetting-ut në këto momente, duke i kthyer ata automatikisht, të varur nga ky vullnet politik sot, dhe në shërbim të presionit politik nesër.

4.2 Nga praktika parlamentare, kjo nismë legjislative e propozuar nga Këshilli i Ministrave, nuk shoqërohet me asnjë analizë që të paktën të orientojë mbi afatin e nevojshëm për përmbylljen e procesit të vlerësimit kalimtar. Nga ana tjetër, nuk jepet asnjë e dhënë nëse kjo nismë për heqjen e afatit të vlerësimit kalimtar, është konsultuar, apo jo, ndërkohë që është miratuar me procedurë të përshpejtuar, pa argumentuar nevojën.

4.3 Në këtë pikë, sërish ripërsërisim qëndrimin e mbajtur në arsyet shoqëruese të Dekretit nr. 11175, datë 19.4.2019 të Presidentit të Republikës, me anë të të cilit është kthyer për rishqyrtim në Kuvend, ligji nr. 20/2019, sa i takon heqjes së detyrimit ligjor për të përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar brenda një afati të caktuar.

Heqja e këtij afati krijon të gjitha premisat për mbajtjen nën presion të vazhduar të forcave policore, tashmë edhe të drejtuesve të lartë, nëpërmjet forcës ndëshkuese të mekanizmit të vlerësimit kalimtar (vetting-ut).

4.4 Veçanërisht kur vendi pritet t’iu nënshtrohet edhe zgjedhjeve të përgjithshme, forcimi i këtij presioni përmes vlerësimit kalimtar (vetting-ut), bëhet akoma më i dëmshëm dhe i rrezikshëm për garantimin e paanësisë së forcave policore e për pasojë, tepër shqetësues.

4.5 Zgjatja e këtij procesi me një afat të papërcaktuar, përveç se nuk përkon me nevojën e menjëhershme që ka shteti shqiptar për një Polici Shteti të kaluar në vetting dhe që të ketë

kaluar procesin e vlerësimit kalimtar (vetting-ut), krijon një gjendje pasigurie të tejzgjatur për çdo punonjës subjekt i ligjit, referuar faktit nëse do ta kalojë apo jo procesin e vettingut.

4.6 Pikërisht, kjo gjendje pasigurie me afat të papërcaktuar e kombinuar edhe me faktin që struktura që do të duhet ta realizojë procesin e vetting-ut është SHÇBA-ja, një strukturë në varësi direkte të një funksionari politik, por mbi të gjitha, proces që duhet të zhvillohet direkt tashmë nga ajo trupë e ngushtë personash, që kanë kaluar procesin e vlerësimit kalimtar, ndikon drejtpërdrejt në rezultatet dhe punën e forcave policore, të cilat do të vihen nën një situatë edhe më të shtuar pasigurie dhe tensioni.

Kjo pasiguri e personelit policor është e pritshme dhe ka gjithë premisat që të keqpërdoret së tepërmi në situata të veçanta, sidomos përgjatë procesit zgjedhor.

4.7 Mospërcaktimi i kohës së mbylljes së procesit të vlerësimit kalimtar (vetting-ut), krijon terren që ky proces të përdoret si një mekanizëm ndëshkimor apo shantazhues për gjithë strukturën policore, çka mund të sjellë një situatë shqetësuese në këtë strukturë. Konkretisht, mospërcaktimi i afatit se kur përfundon procesi “vetting” mund të sjellë:

- a) Rrezikun e ndikimit dhe presionit të vazhduar ndaj veprimtarisë së përditshme të forcave policore;
- b) Mund ta zgjasë kohën e qëndrimit brenda forcave policore të individëve që nuk e meritojnë të jenë pjesë e Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës dhe që për shkak të profilit të tyre, janë lehtësisht të shantazhueshëm.

Heqja tërësore e afatit se kur përfundon ky proces, bie në kundërshtim të hapur me interesin publik që ka vetë realizimi i tij, por gjithashtu edhe me respektimin e të drejtave të subjekteve që do t'i nënshtrohen atij.

4.8 Gjithashtu, përtej këtyre argumenteve të renditura më sipër, të njohura tashmë nga ana juaj pasi ju janë bërë me dije gjatë rishqyrtimit të ligjit nr. 20/2019, duhet të sjellim në vëmendjen tuaj edhe qëndrimin që ka mbajtur Komisioni European për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar në përgjithësi, për Shqipërinë.

Procesi i vlerësimit kalimtar, është një proces jo i zakonshëm, që duhet të kryhet për arsye madhore që lidhen me interesin publik dhe për këtë arsye, mund dhe duhet të jetë vetëm një proces rreptësisht i përkohshëm. Kjo ka qënë dhe ideja e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe po kështu është shprehur edhe Komisioni i Venecias për këtë çështje.

Madje, Komisioni i Venecias, në datën 19 qershor 2020, në Opinionin e miratuar nr. 978/2020 për Shqipërinë “Mbi emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese”, si dhe në dy Opinionet e mëparshme për këtë çështje<sup>3</sup>, ka ripërsëritur qëndrimin se: “Procesi shumë radikal i verifikimit (“vlerësimi i kualifikimit”) i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i krijuar posaçërisht mund të shihet si i përshtatshëm në kontekstin shqiptar, mbi bazën e supozimit - të përhapur gjerësisht - që niveli i korrupsionit në gjyqësorin shqiptar ishte jashtëzakonisht i lartë dhe kërkonte masa urgjente dhe radikale. [...] Sidoqoftë, Komisioni këmbënguli që vettingu mund të ishte vetëm një masë e jashtëzakonshme dhe rreptësisht e përkohshme dhe

Komisioni bëri një numër rekomandimesh në mbrojtje të këtij procesi. [...] procesi i verifikimit duhej të ishte "rreptësisht i përkohshëm", që të mos ndodhte që strukturat e vettingut të zëvendësonin organet e zakonshme kushtetuese. [...] Sidoqoftë, për Komisionin është e qartë se procesi i vetting duhet të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por duke siguruar një shqyrtim të drejtë të secilit rast.”

Këto rekomandime të Komisionit të Venecias për Shqipërinë janë rekomandime që kanë trajtuar thelbin e një procesi të “rivlerësimit kalimtar”, ndaj vlejné dhe duhet të gjejné reflektim pa vonesë edhe në ligjin për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme. Referuar sa më sipër, një ndryshim ligjor i pranueshëm mund të ishte shtytja e realizimit të këtij procesi, deri në datën 31 dhjetor 2020.

- ***Baza ligjore e shqyrtimit të Dekretit***

Baza Ligjore mbi të cilën Komisioni për Sigurinë Kombëtare, shqyrton Dekretin e Presidentit është:

- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 85 të saj përcakton se:***

*Neni 85*

1. *Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.*
2. *Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.*

- ***Rregullorja e Kuvendit, e cila në nenin 86 të saj përcakton se:***

*Neni 86*

*Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji*

1. *Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.*
2. *Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.*

- ***Argumentet ligjore kundër dekretit të Presidentit të Republikës***

Gjatë shqyrtimit të Dekretit të Presidentit të Republikës Ministri i Brendshëm Zoti Lleshaj, i pranishëm në mbledhje, ftoi anëtarët e komisionit të votojnë kundër dekretit duke sjell kundërargumentat si më poshtë:

*“Së pari, dua të them se ky ligj është miratuar në vitin 2018 dhe është dekretuar po nga i njëjti President, i cili në atë kohë nuk ka gjetur probleme thelbësore me frymën e ligjit dhe nuk e konsideronte vettingun për Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe SHÇBA-në si një instrument presioni, siç është rasti i sotëm.*

*Në vitin 2018 Presidenti përmes dekretimit besonte në faktin e vettingu do të mbyllej në vitin 2020 dhe në këtë proces, do të kalonin 14 mijë veta.*

*De facto procesi i vettingut në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe SHÇBA-në, ka filluar në vitin 2018 për arsye se nga miratimi i ligjit deri në vitin 2019 shërbeu si kohë përgatitore për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për këtë proces, pra filloj në vitin 2019.*

*Viti 2019, me dy ngjarje të mëdha siç janë tërmeti dhe COVID-i, pati ndikim të madh në të gjitha axhendat politike, administrative, ekonomike të vendit. Ndër të tjera këto ndikuan shumë edhe në vijimin normal të procesit të vettingut, i cili u ndërpre për shkak të tërmetit, sepse godina ku kryente veprimtari Komisioni i Jashtëm pësoi dëmtime dhe më pas vijoi me COVID-in, i cili e ndërpreu procesin totalisht.*

*Komisioni i Jashtëm i Vetingut kishte detyrim, kishte një afat, qershorin e vitit 2020 për ta mbyllur procesin e vettingut për drejtuesit kryesor të këtij procesi të rëndësishëm.*

*Presidenti i Republikës me kthimin e ligjit në Kuvendin e Shqipërisë kërkon, që procesi të ndërpritet, sepse në qoftë se ne nuk e zgjerojmë arsyen kohore të komisionit të jashtëm, procesi do të ndërpritet, si të thuash në një fazë shumë kritike të tij.*

*Ajo që është më shqetësuese, Presidenti ka goditur thelbin dhe frymën e ligjit për arsye se ai e konsideron vettingun, si instrument presioni.*

*Tani kemi një problem thelbësor këtu, dhe problemi është ky: vetingu në Policinë e Shtetit nuk është ndonjë gjë e re. Në fakt, edhe ligji flet për vlerësimin kalimtar, por edhe periodik të punonjësve të Policisë së shtetit, të Gardës apo të SHÇBA-së, për arsye se këto struktura ligjzbatuese në Shqipëri dhe në çdo vend të botës, duhet që të jenë përherë në një proces verifikimi, në një proces vetingu në qoftë se do.*

*Në qoftë se duam ta konsiderojmë presion, le ta konsiderojmë presion. Është një instrument presioni pozitiv ndaj kujtdo, që merr përsipër të shërbejë në strukturat ligjzbatuese, në Shqipëri dhe në çdo vend normal të këtij planeti.*

*Çdokush që shërben në këto struktura e ka pranuar vetë që do t'i nënshtrohet një verifikimi të përhershëm, do të jetë përherë në një proces verifikimi, për arsye se risku i komprometimit të një personi të caktuar gjatë karrierës është prezent.*

*Pra, vettingu është një proces i përhershëm, jeta në Policinë e Shtetit dhe në Gardë edhe në këto struktura ligjzbatuese është në një proces vettingu të pafundme, të përhershëm*



*dhe këtu nuk ka asgjë të re. E kundërta do të ishte sinjali i gabuar, nëse themi ne e bëjmë vettingun një herë dhe pastaj imunizohemi prej tij dhe nuk kemi më asnjë kontroll, asnjë proces verifikimi në jetë.*

*Jo, është një proces i vazhdueshëm dhe ligji i bërë që në 2018 e ka këtë frymë, sepse flet për vlerësim periodik. Në qoftë se flasim për një vlerësim periodik, atëherë automatikisht duhet të heqim dorë nga konkluzioni i nxituar, për ta konsideruar këtë instrument, si një instrument presioni. Në qoftë se do ta konsiderojmë instrument presioni, pra një instrument të dëmshëm ndaj Policisë, atëherë e njëjta logjikë do të vlente edhe për gjyqësorin. Le ta konsiderojmë edhe këtë një instrument presioni për gjyqësorin dhe të heqim dorë prej tij, sepse po i bëjmë dëm sistemit.*

*Në fakt përmes këtij instrumenti “presioni”, ne besojmë se i është bërë mirë sistemit gjyqësor dhe po i bën mirë, dhe do të t'i bëjë mirë sistemit tjetër që mbështet gjyqësorin që është sistemi i agjencive ligjzbatuese, ku Policia e Shtetit ka një rol të madh dhe ky ka qenë edhe intencioni fillestar kur ka nisur procesi. Meqenëse, policia dhe sistemi i drejtësisë, prokuroria punojnë së bashku në hetimin penal dhe në luftën ndaj krimit, do të plotësojnë të njëjtat standarde për sa u përket kriterëve të integritetit të personelit që përfshihet në këto struktura.*

*Është për të ardhur keq që Presidenti ka shquar dhe disa nuanca elektorale të ligji i miratuar. Në thelb çfarë ndryshimesh sjell ky ligj? Vetëm një element. Ligji rifut në funksion Komisionin e Jashtëm të Vetingut, i cili ka mbyllur aktivitetin për shkak se ligji i ka vënë një afat qershorin e këtij viti.*

*Aktualisht Komisionin e Jashtëm i Vetingut është pezulluar, i ngrirë, për arsye se i ka ikur afati ligjor për të ushtruar mandatin. Çfarë kërkojmë? Parlamenti tashmë ka kërkuar që ky komision të vazhdojë dhe ta mbyllë misionin e tij. Nuk i kemi vënë një afat pikërisht për të shmangur një nevojë për të ardhur prapë në Kuvend. Nuk i kemi vënë një afat kohor, por ama ka një mandat të qartë, sepse ka një numër të kufizuar, të qartë drejtuesish të Policisë, Gardës dhe të SHÇBA-së për të kryer procesin. Janë rreth 250 persona, të cilët do t'i nënshtrohen këtij procesi me parimin e fundit automatikisht mbyllet edhe procesi i vetingut nga Komisioni i Jashtëm.*

*Pastaj procesi i vlerësimit të përhershëm ose vlerësimit periodik, do të kryhet nga SHÇBA-ja, ashtu siç do të kryhet ky proces edhe për pjesën e mbetur, të pjesës së poshtme të hierarkisë.*

*Në fakt, është shqetësuese që Presidenti shquan nuanca elektorale. Këtu duhet vërtet fantazi e tepruar, e jashtëzakonshme për të parë ndonjë lidhje midis zgjatjes së afatit ose vënies në funksion të procesit të vettingut në Polici me zgjedhjet elektorale.*

*Kjo është diçka që del jashtë fuqive përfytyruese tona dhe i mbetet Presidentit, që të thotë se ku i sheh ai rreziqet elektorale nga vetingu në polici. Ne, përkundrazi, besojmë që sa*

*më e pastër të bëhet Policia, Garda dhe SHÇBA, aq më të mira bëhen kushtet që këto institucione të kryejnë me integritet dhe përgjegjësi ligjore punën e tyre.*

*Gjithashtu, është për të ardhur keq që Presidenti në shumë pasazhe të dokumentit që ka sjellë, përdor termin “ngjan me”, “duket se”, “ka mundësi që”, pra janë shprehje të një karakteri shumë evaziv, që në gjykimin tim nuk e kanë vendin në një dokument të këtij niveli presidencial. “Ngjan me”... edhe unë mund të ngjaj me dikë tjetër, por nuk jam ai tjetri, ndërkohë që këtu përdoren si argumente.*

*Vijmë te një çështje tjetër, që ka të bëjë me shqetësimin e Presidentit për kontrollin politik ndaj SHÇBA-së. Është e vërtetë që Policia, SHÇBA, Garda, përgjithësisht institucionet ligjzbatuese në vend, i gjithë aparati ekzekutiv shtetëror, është në varësi politike, është në varësi të qeverisë, por kjo është gjëja më normale në një sistem demokratik, ky qytetarët zgjedhin parlamentin dhe parlamenti zgjedh një qeveri.*

*Në fakt, qeveria ushtron mandat politik në emër të qytetarëve dhe institucionet duhet të jenë dhe janë në varësi të qeverive. Ky është thelbi i demokracisë.*

*Unë nuk kuptoj se në varësi të kujt duhet të ishin, në qoftë se nuk do të jenë në varësi të Ministrisë, apo në varësi të qeverisë?! Nuk ka ndonjë zgjidhje tjetër, kështu që shqetësimet të kësaj natyre më duken vërtet të pakuptueshme dhe të papranueshme, sepse edhe krijimi apo tentativa për të krijuar një ide që varësia e institucioneve ligjzbatuese te qeveria qenka problemi është shumë e rrezikshme, sepse kjo është A-ja e shtetit.*

*Në qoftë se ekzistojnë dyshime për një ministër të caktuar, apo një qeveri të caktuar, dyshimi nuk kthehet kundër sistemit. Në qoftë se paska rrezik që një ministër i caktuar po themi, mund t’i përdorë politikisht ose keqpërdori politikisht kompetencat që i janë dhënë, çështja shtrohet ndaj individit, por jo ndaj sistemit.*

*Nuk mund të pretendojmë ne dhe nuk mund të guxojmë të mendojmë që të ndërtojmë një sistem, ku institucionet nuk janë në varësi të qeverisë, e cila jep llogari te qytetarët. Nuk mund të mendojmë të krijojmë një sistem burokratik me institucione, të cilat janë jashtë kontrollit demokratik, i cili ushtrohet nga parlamenti dhe nga qeveria në emër të qytetarëve.*

*Kështu që tentativa për të krijuar imazhe pavarësie jashtë institucioneve është një tentativë, e cila i bën dëm të madh vetë demokracisë. Gjithmonë, është e rëndësishme të kuptojmë që pavarësia e institucioneve është pavarësia e vendimmarrjes së tyre, e cila duhet bazuar në ligj, dhe jo shkëputje e tyre nga sistemi. Nuk mund t’i bëjmë institucionet e pavarura, duke i shkëputur nga sistemi. Por, institucionet bëhen të pavarura kur atyre u jepet mbrojtje ligjore në ushtrimin e detyrës së tyre dhe ju kërkohet që ta ushtrojnë detyrën dhe përgjegjësinë të bazuar në ligj, kjo është pavarësia. Jo kur vendosen strukturalist, ku i marrin pagat, dhe ku japin llogari për realizimin e objektivave dhe prioritetëve të tyre.*

*Në përgjithësi, unë do të thosha që nuk kemi asnjë mundësi për t'i mirëkuptuar arsyet e Presidentit për kthimin e këtij ligji mbrapsht. Në qoftë se ne do ta prananim kthimin e ligjit mbrapsht, ky do të kishte vetëm një pasojë, do të ndërpriste përfundimisht procesin e vetingut në Policinë e Shtetit, duke i dhënë goditje të madhe gjithë përpjekjes për të kryer një proces verifikimi të integritetit të gjithë sistemit të drejtësisë dhe sistemit të agjencive ligjzbatuese që e mbështesin atë, që është kryesisht Policia e Shtetit.*

*Procesi, i cili duhet të bëhet për shumë arsye, por edhe për një arsye fare të thjeshtë, sepse ai ka filluar tashmë. I ka dhënë efektet e para dhe nuk mund të krijojme pra një situatë pabarazie, disa kanë kaluar procesin disa të tjerëve jua anulojmë për një arsye, që nuk mbështetet asgjekund”.*

Kryetarja e komisionit, zonja Felaj, para se t'i jepte fjalën relatores zonjës Elona Hoxha, u shpres se Presidenti i Republikës ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, i cili është ligji bazë, e ka miratuar në dekretin nr.10747 dt. 20.03.2018.

Një nga arsyet themelore, për të cilat Presidenti i Republikës e dekretoi këtë ligj ishte fakti që ky ligj pati konsensus, i cili dilte përtej maxhorancës. Ky ligj është votuar me 80 vota pro, ku kanë qenë përfaqësues të opozitës parlamentare të asaj kohe, të cilët kërkuan të bënin disa ndryshime në ligji, të cilat u pranuan, ku ndryshimi më kryesor ishte ai i ngritjes së nënkomisionit parlamentar për mbikëqyrjen e këtij procesi, që, në fakt, në raport me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, ka funksionuar rregullisht dhe ka pasur vetëm 32 anëtarë të parlamentit në atë kohë, të cilët kanë abstenuar ligjin.

Pra, palët në vitin 2018 kanë rënë dakord për qëllimin e ligjit, që të vetohet forca e Policisë së Shtetit, si një forcë e cila mbështet të gjithë veprimtarinë e atyre, që sot janë aktorët kryesorë dhe, njëkohësisht, janë të vetuarit në procesin që po ndodh me reformën në drejtësi.

Në vazhdim të fjalës së saj, zonja Felaj shtoi së detyrimi ynë si parlamentarë, detyrimi i Presidentit të Republikës dhe detyrimi i Qeverisë është që në mënyrë të vazhduar të ruaj qëllimin të pa cenuar, pra, të sigurojë që ky proces do të kryhet, të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit do të trajtohen njësoj nga ligji, në kuptimin që do të zbatohen të njëjtat standarde dhe do të vlerësohen nga e njëjta trupë, e cila është përzgjedhur sipas një mekanizmi, i cili të siguronte që kjo trupë të jetë e paanshme dhe e pavarur nga politika.

E vërteta është se trupa, e cila po veton Policinë e Shtetit është një trupë që nuk ka lidhje me institucionet politike dhe në funksion të këtij qëllimi ka qenë sjellja e qeverisë kur propozoi ndryshimet në vitin 2019, mbështetja e parlamentit në rastin kur i miratoi ato ndryshime dhe sërish në vitin 2020, kur edhe pas situatave të fatkeqësive natyrore, që prodhoi fundi i viti 2019 dhe fillimi i viti 2020, u bë e detyrueshme ndërhyrja sërish në ligj.

Mandej, zonja Felaj theksoi se Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka patur një vëmendje ndaj çështjes që lidhet me afatin e kryerjes së punës nga ana e Komisionit të Jashtëm të

Vlerësimi, i angazhuar për të bërë vetimin e gradave të larta, por edhe në përgjithësi të të gjithë procesit, sepse është e nevojshme që ky proces të mbarojë në afate optimale.

Fjalën më pas e mori relatorja zonja Hoxha, e cila solli kundërargumentat si më poshtë:

- Në lidhje me argumentin e Presidenti të Republikës mbi titullin e ligjit 74/2020 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar*”, relatorja zonja Hoxha solli kundërargumentin si më poshtë:

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 427, datë 03.06.2020, i ka dërguar për shqyrtim Kuvendit të Shqipërisë projektligjin *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar”*”.

Sikurse duket qartë, nga ana formale projektligji ka ardhur korrekt, ç’ka do të thotë që kemi të bëjmë me një gabim në zbardhjen e projektligjit.

Ndërsa përsa i përket, shtimit të pikës 3, relatorja theksoi se kjo shtesë është bërë konform rregullave të teknikës legjislative, ku konkretisht pas pikës 2 të nenit 6, është shtuar një pikë e re si pikë 3, ç’ka passjell edhe rinumertimin e pikave vijuese.

- Lidhur me shtimin e pika 3 me këtë përmbajtje:

*“3. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ushtron veprimtarinë paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.”*

Presidenti argumenton se ky saktësim që propozohet sot është në fakt një justifikim i mosvijimit të procesit deri më tani dhe shtesë e përdorur për të justifikuar gjithashtu ndryshimin që i bëhet afatit në nenin 2, të ligjit nr. 74/2020.

Mandej Presidenti i Republikës aludon se ushtrimi paralelisht i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, krijon dyshime të theksuara për selektivitet dhe subjektivizëm në kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar nga ana e SHÇBA-së, pasi ky moment është i lidhur me faktin se sot dihet tashmë se cilët janë personat brenda kësaj strukture (SHÇBA) që kanë kaluar procesin e vlerësimit.

Po ashtu ai thekson se jo vetëm që mungon transparenca mbi mënyrën se si janë përzgjedhur subjektet që kanë kaluar procesin e vlerësimit me përparësi, por rritet dhe mundësia që ky proces të ushtrohet nën ndikim politik, duke mos garantuar standardin e domosdoshëm për realizimin e këtij procesi me objektivitet, pavarësi dhe paanshmëri

Në lidhje me këto pretendime relatorja zonja Hoxha, solli kundërargumentat si më poshtë:

Presidenti i Republikës duhet të jetë shumë objektiv në vlerësimin e punës së kryer deri më tani nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, problematikat që ka hasur ky institucioni që në kohën e krijimit të tij si dhe vonesat që ka hasur jo vetëm për arsye objektive (pandemia, tërmeti) por edhe të vetë vështirësive të hetimit dhe bashkëpunimit me

institucionet, vërshtirësi këto të cilat i janë raportuar dhe bërë me dije në mënyrë periodike Komisionit për Sigurinë Kombëtare dhe Nënkomisionit parlamentar për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Zonja Hoxha u shpreh se referuar nenit 5 të ligjit nr. 70/2014 "Për shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme", objekt i veprimtarisë së Shërbimit janë:

- a) parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;
- b) inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit;
- c) ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;
  - ç) verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
- d) analiza, studime dhe rekomandime të përgjithësuara në bazë të inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e të funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.

Pra keni të bëjmë me një strukturë të konsoliduar që do të ndikojë në shkurtimin e kohës së vlerësimeve individuale, sa kohë që një pjesë e madhe e informacioneve për punonjësit e Policisë apo Gardës gjenden në arkivat e vetë SHÇBA-së si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit, pa harruar rolin e vetë SHÇBA-së në proceset e pajisjes me certifikatë sigurie.

Kjo do bëjë të mundur që procesi mos të zvarritet por të përmbyllet një një kohë optimale pasi vetë ligji vendos disa garanci sikundër janë Nënkomisionin parlamentar "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në ministrinë e Brendshme", i cili organizohet dhe funksionon në përbërje të Komisionit për Sigurinë Kombëtare .

Objekti dhe fusha e veprimtarisë së këtij nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Gjithashtu garancia tjetër konsiston në faktin se nga tre kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligj, konkretisht, vlerësimi i figurës, pasurisë dhe integritetit, mjafton që njëri nga këto kriteret të mos përmbushet automatikisht procedura për këtë subjekt përmbyllet.

- ✚ Në lidhje me argumentin që ka të bëjë me mospasjen e një afati, i cili mund të përdoret në mënyrë selektive në vettingun e subjekteve, sidomos në një periudhë të afërt zgjedhore, në fillim të vitit 2021, gjë që do të sjellë jo vetëm presion te subjektet, por edhe ndikim politik, duke u nisur nga fakti se SHÇBA-ja është një strukturë e varësisë direkte të një funksionari politik, siç është ministri i

Brendshëm, duke shkaktuar presion dhe pasiguri në trupat policore dhe favorizim për drejtuesit e lartë, të cilët të mos kalojnë vetingun sot dhe të bëhen kësisoj të varur politikisht dhe në shërbim të presionit politik nesër, relatorja paraqiti kundërargumentet si më poshtë:

Zonja Hoxha u shpreh se Presidenti i Republikës në tërësi të kthimit të ligjit, ka politizuar gjithë procesin, ka paragjykuar padrejtësisht për varësi politike dy organet ( KJV dhe SHÇBA ) dhe duke paragjykuar njerëzit e vetuar nga SHCBA si të varur nga Ministri.

Në rast se SHCBA-ja është një strukturë e përhershme dhe që funksionin në bazë të një ligji specifik , aty ka percaktime shumë të qarta se si është i organizuar, çfarë objekti pune ka dhe në çfarë statusi varësie është ky organ me Ministrin e Brendshme

Përfshirja e SHÇBA-së në procesin e vetingut në fazën e dytë dhe të tretë të vlerësimit, me ndryshimet e miratuara në vitin 2019 , u bë pasi shkurtonte në mënyrë drastike shpenzimet, duke i kursyer buxhetit të shtetit rreth 260 milionë lekë dhe duke minimizuar kostot shtesë. Për më tepër, SHÇBAja ka në arkivat e saj materiale për efektivat e Gardës dhe Policisë së Shtetit, si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit. Ndaj përfshirja e këtij institucioni në këtë proces u vlerësua si një ndërhyrje që siguron efektivitet të zbatimit të procesit në kosto dhe kohë.

Për aq kohë sa procedurat dhe kriteret e vlerësimit nuk ndryshojnë, vlerësoj se përfshirja e SHÇBA-së nuk e dëmton pavarësinë dhe panshmerine e procesit.

Pra keni të bëjmë me një strukturë të konsoliduar që do të ndikojë në shkurtimin e kohës së vlerësimeve individuale, sa kohë që një pjesë e madhe e informacioneve për punonjësit e Policisë apo Gardës gjenden në arkivat e vetë SHÇBA-së si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit, pa harruar rolin e vetë SHÇBA-së në proceset e pajisjes me certifikatë sigurie.

Ndërkohë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit bazuar në ligjin nr. 12/2018 *“Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme”* është formësuar si një trupë mikse, e jashtme, e paparfishirë në funksione politike , e përzgjedhur nga një Bord përzgjedhës që ka raportuar edhe ky Bord në këtë Komision për mënyrën e përzgjedhjes, kontrollin e bërë ndaj këtyre individëve dhe kriteret e përzgjedhjes.

Pra një strukture komplekse, e përkohshme me një qëllim të përcaktuar në ligjin 12/2018 dhe më tej në ligjin 20/2019 me nje mision dhe objekt : kryerjen e vleresimit kalimtar për një kategori drejtuesish me grada të larta dhe funksione drejtuese në Policinë e Shtetit, SHCBA-në dhe Gardën e Republikës.

Ky organ eshte teresisht i pavarur politikisht nga ekzekutivi dhe te vetmen urë kontrolli dhe monitorimi të punes se tij, ka Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Nënkomisionit parlamentar të ngritur pranë Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Ky ligj ka qenë i mbështetur me asistencë ndërkombëtare nga ICITAP dhe PAMECA, me konsultime të gjera publike, i cili ka sjellë pa dyshim një frymë shumë më moderne dhe komprehsive për sa i përket punës së SHÇBA-së dhe në shërbim të qytetarëve, por, pa dyshim, edhe për sa i përket kontrollit të figurës së punonjësve të policisë.

E fundit, si një element shumë i rëndësishëm, është edhe kompozimi i anëtareve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ku 5 janë nga profesori, 5 inspektorë nga ILDKP-ja dhe 5 zyrtarë të zgjedhur me konkurrim të hapur nga radhët e administratës publike. Pra, është e kuptueshme që nuk ka vend për dyshime të politizimit apo varësisë politike të tyre nga një organ apo institucion shtetëror. Ky organ, parlamenti, është një urë kontrolli dhe monitorimi i punës së tij, ku nëpërmjet nënkomisionit parlamentar të ngritur pranë komisionit të sigurisë, si një fushë përgjegjëse, ku përcaktohet mekanizmi ndjekës dhe kontrolli i zbatimit të këtij ligji. Kjo ishte për sa i përket SHÇBA-së.

Po sipas Presidentit, SHÇBA-ja, është një strukturë e papërshtatshme për të bërë vlerësimin kalimtar të të gjithë trupës policore, pasi është strukturë në varësi të ministrit dhe nuk garanton pavarësi dhe paanshmëri, duke krijuar për Presidentin dyshime të theksuara për selektivitet dhe subjektivizëm në kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar nga SHÇBA. Sipas Presidentit, vihen persona që kanë kaluar vetingun brenda kësaj strukture.

Ralatorja theksoi se legjislacioni shqiptar, Kodi Zgjedhor, legjislacioni i Policisë së Shtetit i ka përcaktimet dhe kufizimet e qarta se çfarë roli ka organizata e Policisë së Shtetit gjatë procesit zgjedhor të zgjedhjeve, qoftë të përgjithshme, qoftë lokale, sepse po të ishte me këtë logjikë, atëherë, nuk do të punonte asnjë organ i vlerësimit kalimtar apo organe të drejtësisë, sepse edhe subjektet e tyre do të jenë të shantazhuara nga kontrole të lidhura me politikën. Kështu që, reforma në drejtësi dhe reforma në polici duhet të vazhdojë të ndjekë rrugën e vet pa u ndikuar dhe pa u lidhur nga proceset zgjedhore dhe as me ndikime të tjera të mundshme institucionale dhe besoj se jemi shumë të qartë në këtë pikë.

Po ashtu Presidenti pretendon që ka munguar transparenca se si janë përzgjedhur subjektet, të cilët kanë kaluar procesin e vlerësimit me përparësi.

Edhe për këtë argument realtorja theksoi se Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.12/2018 për vetingun, i ndryshuar ka realizuar njoftime për publikim të listës me emra të subjekteve, që i janë nënshtruar shortit, sipas rregullores përkatëse të miratuar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, me qëllim rritjen e transparencës. Gjatë hedhjes së shortit kanë qenë të ftuar edhe anëtarë nga nënkomisioni parlamentar për Mbikëqyrjen e Vetingut në Polici, si dhe partnerë ndërkombëtarë përfaqësues nga PAMECA dhe ICITAP.

Zonja Hoxha theksoi se të gjitha përzgjedhjet e anëtarëve të Komisionit dhe sekretariatit kanë qenë transparente dhe janë hedhur në faqe njoftimet për zhvillimin e seancave dëgjimore, njoftimet për kohën e dhënies së vendimit dhe vendimet e zbardhura të tyre.

Nga ana tjetër ky ligj ka qenë i konsultuar, sepse edhe komisioni parlamentar ka ushtruar një mbledhje të gjatë diskutimi më 15 qershor 2020, ku janë ftuar përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe SHÇBA-ja, të cilët e arsyetuan nismën, dhanë mendimet e tyre, pa dyshim edhe shqetësimet, ku u diskutuan problemet e hasura dhe riorganizimi i punës në lidhje me këto.

Argumentet e vjetshme të Presidentit të Republikës për kthimin e ligjit nr. 20/2019, rikthen përsëri në këtë dekret, lidhur me pabesueshmërinë e bërë gjatë procesit të vlerësimit jo nga trupa të pavarura, siç ishin në ligjin bazë fillestar dhe kalimin e kësaj kompetence në dorë të SHÇBA-së dhe kundërshtimin e vazhdueshëm për të mos përcaktuar një afat të përfundimit të vlerësimit nga ana e SHÇBA-së.

Zonja Gjebrea theksoi se vettingu është një proces i përhershëm, i cili do të vazhdojë. Sigurisht që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ka një mandat të kufizuar, ku puna dhe vlerësimi i vazhdueshëm i integritetit të punonjësve të policisë do të jetë gjithmonë nga SHÇBA-ja, ashtu sikurse e ka të përcaktuar në ligj.

Zonja Gjebrea shtoi se qeveria shqiptare pa dyshim është e vendosur për të mbështetur reformat që ndërmerr, qoftë reformën në drejtësi, edhe atë që ka të bëjë me vettingun e policisë. Është e arsyetuar dhe e thënë, tashmë, lidhja që ka një drejtësi e vetuar dhe një trupë policore, që zbaton vendimet e kësaj drejtësie, e cila duhet të jetë sa më profesionale dhe me integritet. Nuk ka pse policia të jetë nën presion sepse policia e di shumë mirë statusin e vet, misionin, detyrat dhe funksionon bazuar në një kuadër të tërë ligjor dhe nënligjor, me një sërë të drejtash, detyrimesh dhe kufizimesh për vetë funksionin e veçantë që ka në misionin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë. Pra, nuk ka pse të paragjykohet puna e policisë si një punë e varur nga një ministër, apo nga një qeveri, sepse Policia e Shtetit është e depolitizuar sipas nenit 4 të ligjit të Policisë së Shtetit nr. 108/2014 dhe statusi, misioni i saj, është i pandryshuar në asnjë moment apo situatë, ku ndodhet vendi apo ndryshon gjendje shteti.

Në fund të fjalës zonja Gjebrea shtoi se argumentet në lidhje me paralelizmin me sistemin e drejtësisë dhe vettingun e prokurorëve dhe gjyqtarëve, nuk qëndrojnë pasi ka një diferencë shumë të madhe midis këtyre dy vlerësimeve, 11 mijë trupë policore me 800 prokurorë dhe gjyqtarë, ashtu sikurse ne kemi kontrollin parlamentar, i cili nuk është në këtë mekanizëm sikurse është vettingu i policisë.

Për sa më sipër zonja Hoxha ftoi anëtarët e komisionit të votojnë kundër Dekretit të Presidentit nr.11536, datë 08.07.2020 “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.74/2020 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar”.



- ***Përfundime***

Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, votoi pro rrëzimit të Dekretit të Presidentit nr.11536, datë 08.07.2020 “Për kthimin në Kuvend të ligjit nr.74/2020 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme*” të ndryshuar” dhe kalimin e tij seancës plenare në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**Relator**

**Elona (Gjebrea) HOXHA**

**Kryetar**

**Ermonela (Felaj) VALIKAJ**